



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

*Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik*

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 30.3.2022, ora 11:30

**Drejton mbledhjen:**

**Flutura Aça – kryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 8 dhe 9 shkurt 2022.
2. Diskutimi dhe miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 28 mars – 15 prill 2022.

**Marrin pjesë:**

Flutura Aça, Teuta Ramaj, Lindita Buxheli, Ilir Topi, Blerina Gjylameti, Florenc Spaho, Dasantila Tahiraj, Enslemvera Zake, Meri Markiçi, Luçiano Boçi, Agron Gjekmarkaj, Ina Zhupa, Andia Ulliri, Eralda Bano, Merita Bakiu dhe Kastriot Piroli.

**Mungojnë:**

Petro Koçi, Besion Ajazi, Eduard Ndreca,

## HAPET MBLEDHJA

### **Flutura Aça – Mirëdita!**

Të nderuar kolegë, sot kemi mbledhjen e paracaktuar të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Para se të kalojmë në detaje, qoftë dhe të miratimit të rendit të ditës, dua të bëj një falënderim personal në adresë të të gjithë kolegëve të komisionit, veçanërisht për zotin Koci, i cili nuk është këtu, por për momentin do t’i marrë falënderimet!

Sigurisht, edhe për stafin kam falënderime të veçanta, sepse ka qenë një periudhë shumë e ngjeshur, pasi kanë kaluar dy procese shumë të rëndësishme, siç ishte p.ligji për ndryshime në Ligjin “Për të drejtën e autorit”, që mendoj se është një nga ligjet më themelore e më të rëndësishme të këtyre 30 vjetëve të fundit, pasi merret me produktin shpirtëror dhe me pasurinë intelektuale, e cila ka pasur probleme shumë të mëdha, që i kemi trashëguar! Ju e dini, në komunizëm produkti shpirtëror ka qenë i partisë dhe posedim i tjetërkujt. Kështu që nuk ka qenë i njeriut, i cili e ka poseduar vetë. Të paktën nga përvoja ime, si një njeri që është marrë drejtpërdrejt me çështjet e së drejtës së autorit për 30 vjet, kam qenë shumë e ndjeshme dhe i kam ndjekur me shumë vëmendje të gjitha komisionet për këtë çështje. Prandaj, doja t’ju bëja një falënderim të veçantë! Personalisht e kam vuajtur dhe kam qenë viktimë e mungesës së këtij ligji. Megjithëse tani janë bërë *rifinitura*, prapëseprapë ndoshta do të ketë nevojë për rishikime të mëvonshme, por të paktën baza është aty. Kështu që ju falënderoj veçanërisht për punën që keni bërë, e cila ka qenë voluminoze gjatë muajit mars!

Së dyti, për plotësimin e vendeve vakante të AMA-s, nuk jam njohur në detaje me kandidaturat, por shpresoj që interesi publik të ketë preluar mbi interesin e partive. Sigurisht, ne jemi partiakë, por gjëja më e rëndësishme është t’u japim qytetarëve njerëz të denjë në pozicionet e tyre. Duke qenë dhe kryetare e këtij komisioni, ndiej njëfarë përgjegjësie publike, që jashtë partive të zgjedhim njerëzit e denjë. Në këtë mes, do të doja që kjo të jetë parasysh edhe në zgjedhjet e ardhshme, në vakancat e ardhshme, që janë shumë shpejt, besoj se janë pas 15 prillit, të cilat kanë të bëjnë me Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

Vazhdojmë me rendin e ditës, me të cilin jeni njohur. A jeni dakord të procedojmë me këtë rend dite që është paracaktuar? Dakord.

Para se të kaloj te procesverbalet e datave 8 dhe 9 shkurt, dua t'ju informoj për një shkresë që ka ardhur edhe në adresë të komisionit tonë, sigurisht, janë informuar të gjitha komisionet parlamentare, që ka lidhje me disa shkurtime buxhetore. Ju e dini, meqenëse jemi “në gjendje lufte”, do të na duhet ta mirëkuptojmë këtë situatë. Shkresa na ka ardhur nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit dhe lidhet dhe me aktin normativ nr.3, datë 12.3.2022, për disa shkurtime buxhetore. Edhe mund ta lexoj, por besoj se secili nga ju do ta marrë *online* dhe do të njiheni konkretisht. Do të na duhet të shkurtojmë shumë gjëra. Në fakt, ne nuk kemi shpenzuar shumë. Në këtë kuptim, kemi qenë një komision shumë i kursyer, por kjo nuk do të thotë që duhet t'i lëmë punët mangët.

Unë kam disa ide për t'i diskutuar me stafin dhe me bashkëpunëtorët, në lidhje me se çfarë do të bëjmë përtej këtyre mbledhjeve rutinë, pra që të bëjmë diçka jashtë zyrës. Kjo do të jetë për muajt e ardhshëm. Kështu që do t'i lutesha stafit t'jua përcjellë këtë shkresë dhe ta lexoni, të njiheni me të, se ku duhet të shkurtojmë dhe çfarë duhet të kursejmë.

Për sa u përket procesverbaleve të datave 8 dhe 9, ju keni qenë vetë të pranishëm dhe i dini. A jeni dakord me to?

Miratohen.

Kalojmë në kalendarin e punës. Sigurisht, edhe prilli, të paktën pas datës 15, do të jetë një muaj i ngjeshur me punë të rëndësishme, të cilat do të na duhet t'i përcaktojmë.

Para së gjithash, kemi një seancë dëgjimore me Agjencinë për Media dhe Informim. Do të na duhet të përcaktojmë një ditë, që duhet të njoftohet në kohë, në mënyrë që të përgatitemi.

A ka propozime për datën?

Po, Ina.

**Ina Zhupa** – Faleminderit!

Në radhë të parë, ju uroj suksese, meqenëse sot zyrtarisht është mbledhja juaj e parë si kryetare, edhe pse jeni votuar disa kohë më parë! Ju uroj shumë suksese në këtë pozicion!

Së dyti, dua t'ju kujtoj se për Agjencinë për Media dhe Informim ne kishim lënë një datë, e cila ishte pushim zyrtar, u vendos më pas të ishte pushim zyrtar, pra ishte e hëna e datës 21. Për këtë arsye, në njëfarë mënyrë, ata janë të informuar se kjo seancë do të bëhet dhe nuk kanë nevojë për më shumë kohë. Kështu që sugjeroj që javën tjetër, nëse biem dakord...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Është javë e gjelbër? Dakord.

Atëherë, sugjerojmë datën 12 për seancën dëgjimore me Agjencinë për Media dhe Informim, ditën e martë, si dhe datën 13 për seancën dëgjimore me Ministren e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Konkretisht, meqenëse java tjetër qenka javë e gjelbër, i bie që mbledhjet të zhvillohen javën e ardhshme, të martën dhe të mërkurën, si ditë më të favorshme për të zhvilluar komisione, duke qenë se zakonisht e hëna përdoret për aktivitete të tjera të grupeve parlamentare.

Faleminderit!

**Flutura Açka** – Besoj se koha është e mjaftueshme për t’u njoftuar dhe për t’u përgatitur pala tjetër.

A ka ndonjë propozim tjetër?

A jeni dakord me datat? Në rregull.

Atëherë, u përcaktuan datat 12 dhe 13. Do të njoftoheni për hollësitë e orarit për të dyja seancat dëgjimore.

Nëse dikush nga ju dëshiron një seancë dëgjimore me përfaqësuesit e Ministrisë së Kulturës, është i hapur ta propozojë qoftë dhe në ndonjë ditë tjetër, sepse mendoj se edhe aty mund të kemi shumë gjëra për të diskutuar.

Këto ditë, pra deri nesër, sipas detyrimit, presim raportin e AMA-s për vitin 2021 dhe raportin e Radiotelevizionit Shqiptar për vitin 2021. Në bazë të tyre do të konkludojmë se me çfarë do të vazhdojmë dhe më vonë do të miratojmë edhe projektrezolutat tona, bazuar në raportet e tyre. Kështu që kjo do të mbetet pas datave 10, 15, kur t’i kemi në dorë raportet e hollësishme dhe të mund t’i studiojmë.

Një çështje tjetër është edhe seanca dëgjimore për të zgjedhur dy kandidatë për dy vende vakante në KDRTSH. Aplikimi është hapur, sikurse është hapur dhe në seancat e tjera. Deri më 15 prill priten aplikimet dhe pas kësaj date do të fillojë procesi i përzgjedhjes së dy kandidatëve. Kështu që edhe kjo do të jetë një punë, që ndoshta do të na duhet ta vendosim pas 15 prillit, kur ta kemi të gjithë informacionin në dorë.

Këto ishin pak a shumë çështjet që kishim sot. Ky është kalendari, të paktën deri më 15 prill.

Ju lutem, nëse keni ndonjë sugjerim qoftë edhe për çështje të tjera, që nuk janë parashtruar në rendin e ditës, mund ta bëni!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Në rregull, atëherë.

Faleminderit shumë për sot!

Mbetemi në...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Procesverbalet e datave 8 dhe 9, si dhe rendin e ditës i votuam. Kështu që jemi në rregull.

Ju faleminderit shumë!

Seanca tjetër është në datën 12 prill. Orari do t'ju njoftohet.

Kalofshi bukur!

**MBYLLET MBLEDHJA**